



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E EDUKIMIT PARAUNIVERSITAR

4266
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 23 . 07. 2012
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

URDHËR

Nr. 300, datë 23.07.2012.

**PËR
REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE TË SHKOLLAVE
PROFESIONALE, ARTISTIKE DHE SPORTIVE**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligjit Nr. 7952, datë 21.6.1995, "Për sistemin Arsimor Parauniversitar" i ndryshuar, ligjit Nr. 8872, datë 29.03.2002 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe ligjit Nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në kuadër të përmirësimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SMI), drejtuesit e shkollave profesionale, artistike dhe sportive, të regjistrojnë elektronikisht të dhënat që i përkasin veprimtarisë së shkollës, sipas fushave të shtojcës nr 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Hedhja e të dhënave të realizohet sipas përshkrimeve në udhëzuesin, sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri, pas trajnimeve për këtë qëllim, të organizuara nga sektori i Zhvillimit të Arsimit Profesional (SZhAP), kompanisë IDRA DiGIS, mbi bazën e projektit Europe Aid/128450/C/SER/AL, "Mbështetje për implementimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri me fokus të veçantë AFP", zbatuar nga kompania INWENT.
3. Drejtuesit e shkollave janë përgjegjës, për saktësinë dhe për hedhjen korrekte të të dhënave sipas fushave përkatëse në SMI.
4. Drejtuesit e shkollave të pajisen zyrtarisht nga administratorët e sistemit me *Username* dhe *Password-in* përkatës.

5. Në përfundim të çdo periudhe të regjistrimit të të dhënave, drejtuesi i shkollës ruan në një dosje të veçantë dokumentacionin e gjeneruar nga sistemi, të printuar dhe nënshkruar prej tij.
6. Periudhat e regjistrimit të të dhënave të përcaktuar nga administratorët e sistemit, të zbatohen nga të gjithë drejtuesit e shkollave.
7. Gjatë një viti shkollor të planifikohen 3 periudha për regjistrimin e të dhënave.
8. Periudha e parë e regjistrimit fillon në shtator 2012 sipas një kalendari të përcaktuar nga administratorët e sistemit. Për çdo ndryshim eventual të të dhënave gjatë periudhës ndërmjet dy *regjistrimeve elektronike* gjatë një viti shkollor, drejtuesit e shkollave të njoftojnë administratorët e sistemit, që të krijojnë mundësinë e përditësimit të nevojshëm.
9. Në rast zëvendësimi të drejtuesit të shkollës, drejtori i DAR/ZA-së njofton administratorët e sistemit, të cilët pajisin drejtuesin e ri të shkollës me *Username* dhe *Pasword* përkatës.
10. Drejtuesit e DAR/ZA-së, të marrin të gjitha masat e nevojshme që shkollat të kenë akses të plotë në Internet, për të realizuar e garantuar në kohë dhe me cilësi funksionimin e SMI.
11. Administrimi i SMI dhe proceseve që lidhen me mirëmbajtjen e tij të realizohet nga specialistë të Sektorit të Zhvillimit të Arsimit Profesional dhe sektorit e-Edukimit.
12. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e e-Edukimit dhe Statistikës, Sektorit të Zhvillimit të Arsimit Profesional, sektori i e-Edukimit DAR/ZA-të dhe shkollat profesionale, artistike dhe sportive.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MYQEREM TAJAJ

MINISTËR

